



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:049964

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05525525

P.nr.842/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Penal, gjyqtari Sabit Sadikaj, me bashkëpunëtorin profesional Asdren Selmani, duke vendosur, në çështjen penale ndaj të pandehurve, A.I dhe A.Gj për shkak të veprës penale “Lëndim i lehtë trupor” nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr. 5587/17 e datës: 21.04.2020, mbajti shqyrtimin fillestar me datë: 15.03.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Arianit Salihu, të pandehurit A.I me përfaqësuesen ligjore Marigona Shala, si dhe i pandehuri A.Gj, ndërsa me datë: 19.03.2024, mori dhe shpalli, kurse me datë: 27.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurve,

1. A.I i biri i A dhe nënës A e gjinisë H, i lindur me “data e lindjes” ne Prishtine, me vendbanim ne rrugën “emri i rrugës” ne Prishtine, i pa martuar, me nr. personal “letërnjoftim”, ka te kryer shkollën e mesme, me profesion “profesioni”, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.
2. A.GJ i biri i A dhe nënës M e gjinisë Gj, i lindur me “data e lindjes” ne Fushe Kosove, me numër kontakti “telefon”, i pa martuar, me nr. personal “letërnjoftim”, i punësuar, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

Gjykata konform nenit 362 paragrafi. 1 nen par 1.3 të KPPRK-së, ndaj të pandehurve, vendosi qe të:

REFUZOHET AKUZA

Sepse:

Me datë 22.06.2017, rreth orës 03:00, në diskotekën "Dublex" , në Rr. Enver Zymberi Prishtinë, e dëmtuara B.M, përderisa kanë qenë në lokalin "Dublex" në Prishtinë, të pandehurit A.I dhe A.Gj, pas një mosmarrëveshje verbale janë rrahur në mes vete me grushta dhe me disa persona

të tjerë të panjohur, ku kanë gjuajtur edhe njeri tjetrin me shishe (të qelqit), ku nga këto gjuajtje me shishe, e dëmtuara B.M ka marrë lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

- me këtë kishin për të kryer veprën penale “Lëndim i lehtë trupor” nga neni 188 par.2 lidhur me par 1. Pika 1.4 të KPRK-së.
- Për shkak se për këtë vepër penale ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.
- Shpenzimet procedurale dhe paushalli gjyqësorë bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.
- Pala e dëmtuar B.M me vendbanim në rr “rruga” Prishtinë, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr. 5587/17 e datës: 21.04.2020, kundër të pandehurve A.I dhe A.Gj për shkak të veprës penale “Lëndim i lehtë trupor” nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, Lidhur me shqyrtimin e kësaj qështje, gjykata me datë: 15.03.2024, mbajti seancën e shqyrtimit fillestar ku morën pjesë prokurori i shtetit Arianit Salihu, i pandehuri A.I me përfaqëuesen ligjore Marigona Shala, si dhe i pandehuri A.Gj ku në këtë seance të pandehurit janë deklaruar.

I pandehuri A.I në seancën e shqyrtimit fillestar, kishte deklaruar, se e pranon fajësinë, për veprën e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, si dhe ka kërkuar falje për atë që kishte ndodhur, si dhe premtonte se nuk do të ndodhë me asnjëherë.

I pandehuri A.Gj në seancën e shqyrtimit fillestar, kishte deklaruar, se e pranon fajësinë, për veprën e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, , si dhe premtonte se nuk do të ndodhë me asnjëherë, kishte ndodhur pasi që ishte nën ndikimin e alkoolit.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit në seancën e shqyrtimit fillestar, prokurori i shtetit kishte deklaruar se, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, pasi që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare si dhe i bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lendes.

Gjyqtari i çështjes pas deklarimit të palëve, kishte marrur aktvendim mbi bazën e të cilit e ka aprovuar pranimin e fajësisë pasi që konstaton se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe imponim, të pandehurit i kanë kuptuar mjaftueshëm benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe me aktvendim ka përfunduar seancën duke caktuar shpalljen e aktgjykimit me datë 19.03.2024.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas shqyrtimit të lëndës, si dhe pas analizimit të saj për të bere shpalljen e aktgjykimit, ka konstatuar se në mbështetje të dispozitave nga neni 106 dhe 107 të Kodit Penal të Republikës Kosovës, ndalohet ndjekja e mëtutjeshme penale ndaj të akuzuarve, pasi që kanë kaluar afatet e caktuara ligjore nga koha e kryerjes së veprës penale, pasi që kemi të bëjmë me parashkrim, në rastin konkret për veprat penale “lëndim i lehte trupor” nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, nuk mund të ndërmerret ndjekja penale pasi që kanë kaluar afatet ligjore për ndërmarrjen e veprimeve. Për veprën penale kryerësi dënohet me burgim deri në tri (3) vjet, kurse në bazë të nenit 106 par.1.5 të KPP-së, *“ndjekja penale nuk mund te ndërmerret nëse kanë kaluar afatet si më poshtë”*, ku sipas nën par. 1.5, i po këtij neni është *“tri vite për veprat penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim;”*, që nënkupton se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret pasi që kanë kaluar mbi 3 vite, ndërsa sipas nenin 107 par. 8 te KPRK-së *“ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale)*, andaj në lidhje me kohën e dyshimit të kryerjes së kësaj vepre penale me datë: 22.06.2017, e lidhur me nenin 106 par.1 nën par. 1.5 e lidhur me nenin 107 par. 8 te KPRK-së, në këtë rast penal, kemi parashkrim absolut të ndjekjes penale, pasi që ka kaluar më shumë së (6) vite nga koha e kryerjes së veprës penale. Parashkrimi absolut në këtë rast penal ka arritur me datë: 23.06.2023, pasi që brenda kësaj periudhe kohore, nuk ka përfunduar ndjekja penale.

Gjykata bazuar në nenin 362 paragrafi 1, nen paragrafi 1.3 të KPPRK-së e refuzoj akuzën për veprën penale “lëndim i lehte trupor” nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, duke u bazuar në nenin 106 par.1 nën par.1.5, e lidhur me nenin 107 par.8 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 dhe 453 par.1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 362 par1 pika 1.3 Te KPPRK-së, vendosi si në diapozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr 842/20, datë: 27.03.2024

Bashkëpunëtori profesional:
Asdren Selmani

Gjyqtari:
Sabit Sadikaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.